

## Rreth CESSDA ERIC

CESSDA ERIC ofron shërbime në shkallë të lartë, të integruara dhe të qendrueshme për Shkencat Sociale. Ajo bashkon arkivat e të dhënave të Shkencave Sociale në Europë, me synim promovimin e rezultateve të kërkimeve në Shkencat Sociale dhe mbështetjen e kërkimit shkencor si edhe bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar në këtë fushë.

### **CESSDA ERIC**

Parkveien 20  
5007 Bergen, Norway  
Tel: +47 55 58 36 48  
Email: [cessda@cessda.eu](mailto:cessda@cessda.eu)  
Web: [www.cessda.eu](http://www.cessda.eu)



## Shërbimi Kombëtar i të Dhënave për Shkencat Sociale - Shqipëri

### ASHDHSHS

## Arkiva Shqiptare e të Dhënave për Shkencat Sociale

### Arsyet për ngritjen e shërbimit kombëtar të të dhënave të shkencave sociale

Nisur nga perspektiva e politikave të kërkimit shkencor, shërbimet kombëtare të të dhënave për shkencat sociale ofrojnë një sërë përfitimesh ndaj komunitetit shkencor duke justifikuar në këtë mënyrë investimin e nevojshëm për krijimin e tyre.

#### **Aksesi afatgjatë**

Për të garantuar një përdorim më të gjerë dhe më efektiv të të dhënave ekzistuese, duke respektuar parimet e FAIR (Findable – të identifikueshme, Accessible – të aksesueshme, Interoperable – të ndërveprueshme, Reusable – të ripërdorshme).

#### **Përdorim më efikas i financimeve publike**

Të dhënat e shkencave sociale që janë të financuara nga para publike shfrytëzohem më tej nga përdoruesit dytësor për kontribute të reja shkencore.

#### **Praktika dhe cilësi më të konsoliduara të kërkimit shkencor**

Kërkimi shkencor bëhet më transparent dhe më i hapur ndaj iniciativave të tjera të ngjashme.

#### **Financimet dhe botimet në revista**

Një kërkese gjithnjë e më shpeshte që të dhënat të depozitohen në arkiva.

#### **Vlere e shtuar për kërkimin dytësor**

Te dhënat dytësore janë të vlefshme për lektorët në universitete, studentët, shoqërinë dhe biznesin.

## Cilët jemi ne?

**Arkiva Shqiptare e të Dhënave për Shkencat Sociale (ASHDHSHS)** do të jetë një infrastrukturë kombëtare kërkimi që siguron ruajtjen dhe shpërndarjen e të dhënave kërkimore në Shkencat Sociale në Shqipëri. Aktorët kryesorë mbi koordinimin e punës për ngritjen e ASHDHSHS do të jenë Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit në bashkëpunim me institucione e aktorë të tjerë që mund të luajnë rolin e institucioneve pritëse për shërbimin kombëtar të të dhënave në fushën e shkencave sociale.

## Misioni ynë

Misioni ynë është menaxhimi i mbledhjes së të dhënave dhe ofrimit të tyre me qëllim mbështetjen e kërkimit shkencor me cilësi të lartë, mësimdhënies dhe mësimnxënies në Shkencat Sociale në Shqipëri. Nëpërmjet krijimit të burimeve dixhitale që janë të lidhura me to synojmë shpërndarjen e tyre tek të gjithë përfituesit e mundshëm.

## Cfarë bëjmë ne?

Aktivitetet kryesore të ASHDHSHS do të fokusohen në:

- » mbledhjen e të dhënave kërkimore të rëndësishme nga shumë disiplina të Shkencave Sociale;
- » sigurimin e ruajtjes digjitale afatgjatë;
- » garantimin e aksesit duke mundësuar përdorim të lehtë dhe të mirëinformuar për qëllime të ndryshme;
- » trajnimin e kërkuesve shkencorë dhe ofruesve të të dhënave të shkencave sociale në planifikim, menaxhim dhe përgatitjen e tyre për shfrytëzim përmes aksesit të hapur;
- » ofrimin e mbështetjes dhe trajnimin e përdoruesve të shërbimeve të të dhënave të shkencave sociale
- » promovimin aktiv të përdorimit dytësor të tyre nga përdorues të ndryshëm.

## Cfarë lloj të dhënash disponojmë ne?

ASHDHSHS do të mbledhë të dhëna mbi një sërë disiplinash të gjera të Shkencave Sociale. Këto përfshijnë të dhëna sasiore dhe cilësore. Fokusi kryesor do të jenë të dhënat sasiore në disiplina si antropologjia, sociologjia, shkencat politike, psikologjia, shkencat shoqërore, shkencat e informacionit, ekonomia, demografia, dhe gjeografia.

Shërbimi i të dhënave në fushën e shkencave sociale gjithashtu do të mbledhë dhe administrojë të dhëna cilësore përmes një përzgjedhje të kujdesshme dhe duke marrë në konsideratë burimet e disponueshme. Të dhënat cilësore do të përfshijnë në fazën e parë historinë rrëfimtare dhe projektet e historisë së jetës, si edhe studime të tjera narrative, që ndërmerren nga akademitë në bashkëpunim me OJF-të.

## Kujt i shërbejmë?

ASHDHSHS synon të ofrojë shërbime ndaj komunitetit akademik – studiuesve universitarë, mësuesve dhe studentëve (doktorantë, master, bachelor), si edhe ndaj kërkuesve shkencorë nga institucione të tjera publike (institute shkencore, agjenci qeveritare), dhe ato nga institucione private si OJF-të, kërkuesit e pavarur, gazetarët, dhe kompanitë private të kërkimit. Për institucione / individë të tjerë, shërbimi i të dhënave rezervon të drejtën për të vendosur bazuar rast-mbas-rasti.

ASHDHSHS ka një rrjet të gjerë arkivash në Europë për të ofruar mbështetjen e nevojshme nëpërmjet CESSDA ERIC.

## Më tepër informacion

Kontakti: Drejtori i Përgjithshëm i AKKSHI, Z. Geron Kamberi  
(Geron.Kamberi@nasri.gov.al).